

SPECIFIKIME TEKNIKE:
MOBILIMI I SPITALIT TË KARDIOKIRURGJISË NË QSUT
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE
“NENE TEREZA”
TIRANE

Permbajtja

1. Fjalor i termave.....	2
2. Objekti.....	2
3. Artikujt dhe specifikimet teknike.....	3-47
4. Tabela e artikujve.....	48-51

1. FJALORI I TERMAVE

Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilimin e Spitalit të Kardiokirurgjisë në QSUT, për dhoma pacienti, dhoma stafi, ambiente spitalore, sallat operatore, reanimacioni etj. Në këtë kategori përfshihen: tavolina, komodinë dhomë pacienti, karrige, dollape, dollape dhomë pacienti (dy kanata, një kanatë), etazherë, komodina, dollape metalike, tavolina për instrumenta, tavolina anestezie si dhe materiale të tjera që janë në funksion të mobilimit të zyrave të mjekëve, infermierëve, stafit spitalor dhe ambienteve të tyre të nevojshme.

2. OBJEKTI

Objekt i këtij katalogu është përcaktimi i nevojave dhe hartimi i specifikimeve teknike për Mobilimin e Spitalit të Kardiokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

3. ARTIKUJT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Dollap dhomë pacienti (dy kanata)

- Dollap për dhomë pacienti me dimesione jo më të vogla se (90 x45/ h =190) cm dhe maximum (100x 50/ h= 200) cm, me dy hapësira secila me kanatë më vete. Secila kanatë të ketë 3 ndarje (dy sergjen).
- Materiali i dollapit do të jetë MDF me trashësi 1.8-2.6 cm si edhe ndarjet (sergjenët). Të jetë lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë, antibakterial dhe rezistent ndaj faktorëve të jashtëm.
- Në pjesët e dukshme, të skeletit dhe kanatave të ketë veshje prej materiali plastik PVC jo më të hollë se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si ajo e materialit të dollapit.
- Të jetë i pajisur me hekur për varjen e rrobave.
- Kanatet do të montohen me mentesha te cilësisë së lartë me thithje.
- Kanatat të jenë të pajisura me bravë (për mobilje) në mënyrë që të mbyllen nga ana e jashtme me çelës.
- Dorezat të jenë prej materiali metalik të cilësisë së lartë, rezistente ndaj agjentëve të jashtëm, antibakteriale dhe ergonomike.
- Të jetë i pajisur me këmbë metalike tubulare me lartësi 8-10cm, material çelik inoxi #304, me mundësi nivelimi. Në pjesën fundore të jenë të veshura me tapa plastike mbrojtëse kundër gërvishtjes.
- Shpina e mobiljes të jetë fiber me trashësi 4-6 mm trashësi.
- Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paketohen sipas kërkesave të nevojshme në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit të tyre.
- Të plotësojë kërkesat sipas standartit: **EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015 ose ekuivalenteve te tij.**



Foto reference

2. Dollap dhomë pacienti (nje kanatë)

- Dollap në dhomë pacienti me dimensione jo më të vogla se (45 x 45/ h= 190) dhe maximum (50x 50/ h= 200) cm me material prej Mdf me trashësi/ spesor 1.8- 2.6 cm, me veshje plastike PVC në pjesët e dukshme. Materiali duhet të ofrojë qëndrueshmëri, të jetë lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë, të jetë antibakterial.
- Në pjesën e brendshme të jetë me tre hapësira (2 sergjenë). Ndarjet të jenë prej materiali Mdf me veshje plastike PVC në pjesët e dukshme, njësoj si edhe struktura. Të jetë i pajisur me hekur për varjen e rrobave.
- Kanata të jetë material i njëjtë me strukturën. Të jetë e pajisur me dorezë alumini të cilësisë së lartë. Kanatet të montohen me mentesha të cilësisë së lartë me thithje. Të jetë e pajisur me çelës (bravë për mobilje) për mbyllje nga ana e jashtme.
- Në pjesën fundore të jetë i pajisur me këmbë metalike me lartësi 8-10 cm prej material çelik inoxi # 304 dhe me mundësi nivelimi. Këmbët të jenë të veshura me tapa plastike në pjesën fundore në mënyrë që të shmangen dëmtimet apo gërvishtjet në dysHEME.
- Shpina e mobiljes të jetë fiber 4-6 mm trashësi.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohen në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat sipas standarteve: **EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015 ose ekuivalentëve të tij.**



Foto reference

3. Komodine dhomë pacienti

- Komodine me përmasa min (45x 50/ h= 75) cm dhe maximum (55x 60/ h= 80) cm.
- Komodinë dhomë pacienti e bërë me mbulesë plastike e derdhur në një trup të vetëm. Dyert janë prej plastike të derdhur.
- Tavolina e integruar me përmasa min (70 x 40 x 98) cm dhe maksimum (85 x 45 x 116) cm.

- Tavolina e integruar rrotullohet rreth boshtit të saj dhe mund të ndryshojë lehtësisht lartësinë. Lartësia varion midis 980 mm dhe 1160 mm. Pjesa e sipërme (pjesa për tavolinë) mund të rrëshqasë gjithashtu horizontalisht.
- Sirtari i vetëm mund të tërhiqet nga të dyja anët, dhe dyert e komodinës rrotullohen në mentesha me një hapje min 180°.
- Komodina e pacientit duhet të ketë material që të pastrohet lehtë, të ketë rezistencë mekanike, peshë e ulët.
- Komodina duhet të ketë standard dhe të jetë antibakteriale, me mbulesë plastike, dhe përbërje e cila mbron sipërfaqen nga bakteret.
- Komodina ka një mbështetëse peshqirësh në njërën anë dhe një mbajtëse për dy shishe në anën tjetër; Të dyja hapësirat janë të futura në vetë kornizën e strukturës.
- Brenda të ketë dy raftë të lëvizshëm.
- Rafti i sipërm është bërë nga laminat plastik me shtresa me trashësi 10 mm;
- Rafti i poshtëm është bërë nga plastikë e derdhur, e shpuar për të lejuar ventilim të duhur.
- Materialet e përdorura lejojnë pastrim dhe dezinfektim efektiv.
- Komodina dhe të gjithë përbërësit e saj janë gjithashtu plotësisht të papërshkueshëm nga uji.
- Të plotësojë kërkesat sipas standartit **ISO 13485:2016, ose ekuivalentëve të tij**



Foto reference

4. Dollap/ Zyrë Mjeku

- Dollap me dimesione min (80 x45/ h =200) cm dhe maximum (90x 55/ h= 210) cm, me dy kanata, secila me hapësira më vete. Njëra hapësirë do të shërbejë për të varur rroba dhe do të ketë 3 ndarje (dy sergjen) dhe tjetra do të jetë me raftë me 5 ndarje (4 sergjenë) me mundësi ndryshimi të lartësisë.
- Ndarjet në hapësirën me tre ndarje të jenë me largësi njëra nga tjetra jo më të vogël se 30cm.

- Materiali i dollapit do të jetë MDF me veshje plastike në pjesët e dukshme, me trashësi 1.8- 2.6 cm si edhe ndarjet (sergjenët).
- Hapësira për kremastar të jetë jo më e vogël se $h = 120-130$ cm dhe të jetë e pajisur me aksesarin për varjen e rrobave.
- Aksesorët të montohen me elemete mbajtëse të qëndrueshme për peshat e rrobave dhe të jenë të cilësisë së parë.
- Këmbët e dollapit të jenë metalike me lartësi 8-10 cm prej material çelik inoxi #304. Të jenë të pajisura me tapa plastike kundër gërvishtjes në pjesën fundore dhe me mundësi nivelimi.
- Në pjesët e dukshme, të skeletit dhe kanatave të ketë veshje prej materiali plastik PVC jo më të hollë se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si ajo e materialit të dollapit.
- Për montimin e kanatave të përdoren mentesha prej materiali të cilësisë së parë me thithje.
- Kanatat të jenë të pajisura me bravë (për mobilje) në mënyrë që të mbyllën nga ana e jashtme me çelës.
- Dorezat të jenë prej material metalik alumin të cilësisë së parë. Të jenë antibakteriale, rezistente ndaj agjentëve të jashtëm (psh. Alkooli etilik, rrezet uv, zbardhja, etj.) dhe ergonomike.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paketohen sipas kërkesave të nevojshme në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit të tyre.
- Të plotesojë kërkesat sipas standartit **DS CEN/ TS 16209:2011 ose EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015** ose ekuivalentit të tij.



Foto reference

5. Dollap Zyre

- Dollap me dimesione jo me te vogla se (80 x 45/ $h = 200$) cm dhe maximum (90 x 55/ $h = 210$) cm, me dy kanata. Të jetë me 6 ndarje (pesë sergjen) me mundësi ndryshimi të lartësisë.
- Ndarjet të jenë me largësi njëra nga tjetra përafërsisht 30 cm, me mundësi ndryshimi të lartësisë.
- Materiali i dollapit do të jetë MDF, me trashësi 1.8- 2.6 cm si edhe ndarjet (sergjenët).
- Këmbët e dollapit të jenë metalike me lartësi 8- 10 cm prej material çeliku inoxi #304. Të jenë të pajisura me tapa plastike kundër gërvishtjes në pjesën fundore dhe me mundësi nivelimi.

- Në pjesët e dukshme, të skeletit dhe kanatave të ketë veshje prej materiali plastik PVC jo më të hollë se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si ajo e materialit të dollapit.
- Për montimin e kanatave të përdoren mentesha prej materiali të cilësisë së parë me thithje. Menteshat të jenë të vendosura dhe të kapura në tre akse.
- Dorezat të jenë prej material metalik alumin të cilësisë së parë. Të jenë antibakteriale, rezistente ndaj agjentëve të jashtëm (psh. Alkooli etilik, rrezet uv, zbardhja, etj.).
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohen sipas kërkesave të nevojshme në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit të tyre.
- Të plotësojë kërkesat sipas standarti **DS CEN/ TS 16209:2011 ose EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015 ose ekuivalentit të tij.**



Foto reference

6. Tavoline Drejtkëndore/ Zyre

- Tavolinë pune, të jetë me dimensione min (160 x 80/ h= 65) cm dhe maximum (170x 90/ h= 75) cm, me syprinë prej materiali MDF me trashësi/ spesor 2.5- 3.2 cm.
- Materiali duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, antibakterial dhe lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë. Në pjesët anësore dhe të dukshme, syprina të jetë e veshur me material plastik PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si struktura.
- Në sipërfaqen e saj, në njërën anë (në të majtë ose në të djathtë) të ketë një hapje (vrimë) në formë rrethore ku fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri, e cila do të shërbejë për kalimin e kablove nga lart -poshtë apo anasjelltas.
- Konstruksioni mbajtës në të cilin do të fiksohet syprina, të jetë metalik me profile në formë drjetëkëndore, me gjerësi të seksionit 4-8 cm. Ky konstruksion të jetë prej çeliku, i qëndrueshëm ndaj goditjeve, shtypjeve dhe agjentëve të jashtëm dhe me spesor 2-4 mm.
- Konstruksioni të lyhet me bojë në ngjyrën e cila do të vendoset nga kontraktori.
- Montimi i syprinës të bëhet me anë të elementëve të fortë dhe të qëndrueshëm në fortësi, në shtypje dhe goditje.
- Në pjesën e përparme tavolina të jetë e mbyllur deri në gjysmën e saj. Materiali i cili do të përdoret për mbyllje të jetë i të njëjtit material me tavolinën, MDF, me trashësi 1.6- 3 cm.
- Ngjyra e materialit do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohet sipas kërkesave të nevojshme për transport në mënyrë që të shmangen dëmtimet.

- Të plotësojë kërkesat sipas standartit: **DS CEN/ TS 16209:2011 ose SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), ose ekuivalentit te tij.**



Foto reference

7. Tavoline Zyre (Model II)

- Tavoline pune, të jetë me dimensione jo më të vogla se (140 x 70/ h= 65) cm dhe maximum (150x 80/ h= 75) cm, me syprinë prej materiali MDF me trashësi/ spesor 2.5- 3.2 cm.
- Materiali duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, antibakterial dhe lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë. Në pjesët anësore dhe të dukshme, syprina të jetë e veshur me material plastik PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si struktura.
- Në sipërfaqen e saj, në njërin anë (në të majtë ose në të djathtë) të ketë një hapje (vrimë) në formë rrethore ku fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri, e cila do të shërbejë për kalimin e kablove nga lart -poshtë apo anasjelltas.
- Konstruksioni mbajtës në të cilin do të fiksohet syprina, të jetë metalik me profile në formë drjetëkëndore, me gjerësi të seksionit 4-8 cm. Ky konstruksion të jetë prej çeliku, i qëndrueshëm ndaj goditjeve, shtypjeve dhe agentëve të jashtëm dhe me spesor 2-4 mm.
- Konstruksioni të lyhet me bojë në ngjyrën e cila do të vendoset nga kontraktori.
- Montimi i syprinës të bëhet me anë të elementeve të fortë dhe të qëndrueshëm në fortësi, në shtypje dhe goditje.
- Në pjesën e përparme tavolina të jetë e mbyllur deri në gjysmën e saj. Materiali i cili do të përdoret për mbyllje të jetë i të njëjtit material me tavolinën, MDF, me trashësi 1.6- 3 cm.
- Ngjyra e materialit do të vendoset nga kontraktori.
- Të pakëtohet sipas kërkesave të nevojshme për transport në mënyrë që të shmangen dëmtimet.
- Të plotësojë kërkesat sipas standartit: **DS CEN/ TS 16209:2011 ose SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), ose ekuivalentit te tij.**



Foto reference

8. Tavoline zyre/ (Model III)

- Tavolinë pune për zyrë të jetë me dimensione jo më të vogla se (120 x 60/ h= 65) dhe maximum (130x 70/ h= 75) cm, me syprinë prej materiali MDF me trashësi/ spesor 2.5- 3.2 cm.
- Materiali duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, antibakterial dhe lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë. Në pjesët anësore dhe të dukshme, syprina të jetë e veshur me material plastik PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si struktura.
- Në sipërfaqen e saj, në njërën anë (në të majtë ose në të djathtë) të ketë një hapje (vrinë) në formë rrethore ku fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri, e cila do të shërbejë për kalimin e kablove nga lart -poshtë apo anasjelltas.
- Konstruksioni mbajtës në të cilin do të fiksohet syprina, të jetë metalik me profile në formë drjetëkëndore, me gjerësi të seksionit 4-8 cm. Ky konstruksion të jetë prej çeliku, i qëndrueshëm ndaj goditjeve, shtypjeve dhe agjentëve të jashtëm dhe me spesor 2-4 mm.
- Konstruksioni të lyhet me bojë në ngjyrën e cila do të vendoset nga kontraktori.
- Montimi i syprinës të bëhet me anë të elementëve të fortë dhe të qëndrueshëm në fortësi, në shtypje dhe goditje.
- Në pjesën e përparme tavolina të jetë e mbyllur deri në gjysmën e saj. Materiali i cili do të përdoret për mbyllje të jetë i të njëjtit material me tavolinën, MDF, me trashësi 1.6- 3 cm.
- Ngjyra e materialit do të vendoset nga kontraktori.
- Të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme.
- Të paktohet sipas kërkesave të nevojshme për transport në mënyrë që të shmangen dëmtimet.
- Të plotësojë kërkesat sipas standartit: **DS CEN/ TS 16209:2011** ose **SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), ose ekuivalentit të tij.**



Foto reference

9. Komodine zyre

- Komodinë zyre min (45 x 60 x/ h= 65) cm dhe maximum (50x65x/ h=70) cm.
- Materiali i përdorur do jetë pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm.
- Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave.
- Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC me trashësi 0.8 mm.
- Duhet të jetë e pajisur me tre sirtare. Shinat e sirtareve me thithje. Fundi i sirtarëve dhe shpina me fibër 4 mm trashësi.

- Do të mbështetet mbi katër rrota sferike me lartësi 5 cm.
- Dorezat e kanatëve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.
- Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015



Foto reference

10. Tavoline zyre mesi

- Tavolinë katrore me dimensione min (50x 50/ h= 40) cm dhe maximum (60x 60/ h= 50) cm. Të jetë prej materiali melaminë me trashësi 16mm- 25 mm. Në pjesët e dukshme të jetë e veshur me material plastik PVC me trashësi jo më të vogël se 1mm dhe me të njëjtën ngjyrë me tavolinën. Pjesa mbajtëse e strukturës të jetë me profil metalik në formë kuadratike.
- Struktura metalike të jetë prej material çeliku.
- Në pjesën fundore këmbët të jenë të pajisura me elemente plastike të cilat janë kundër gërvishtjes.
- Të montohen me elemente të cilët i japin tavolinës pamje solide.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohet në menyrrë të tillë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat sipas standarteve: **SSH EN 527-1:2011 ose ekuivalentit të tij. SSH EN 527-2:2016 ose ekuivalentit të tij. DS CEN/TS 16209:2011 ose ekuivalentit të tij.**



Foto reference

11. Tavolinë sallë mbledhjesh

- Tavolinë për sallë mbledhjesh të jetë me dimensione jo më të vogla se (220x 90 / h= 65) cm dhe maximum (230x 100/ h= 75) cm, me syprinë prej materiali MDF me trashësi/ spesor 3cm.
- Materiali duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm dhe lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë. Këndet e syprinës të jenë të rrumbullakosura. Në pjesët anësore dhe të dukshme, syprina të jetë e veshur me material plastic PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë si struktura.
- Konstruksioni mbajtës në të cilin do të vendoset syprina, të jetë metalik, në formë drjetëkëndore, me gjerësi të seksionit 4-8 cm. Në të gjithë gjatësinë e tavolinës të jenë të vendosur 3- 4 konstruksione të tilla të cilat të lidhen me njëra tjetrën nëpërmjet një ose dy elementëve të tjerë gjatësor me po të njëjtat dimensione, nëpërmjet saldimit.
- Lidhja të bëhet si në pjesën e sipërme ashtu edhe në pjesën e poshtme. Ky konstruksion të jetë prej çeliku, i qëndrueshëm ndaj goditjeve, shtypjeve dhe agjenteve të jashtëm, me dimensione (70- 80x h= 62-72) cm, në formë drejtkëndore.
- Në pjesën e poshtme konstruksioni të pajiset me elemente prej gome ose plastike në mënyrë që të shmangen gërvishtjet në dysheme.
- Të lyhet me bojë në ngjyrën e cila do të vendoset nga kontraktori.
- Montimi i syprinës të bëhet me anë të elementeve të fortë dhe të qëndrueshëm në fortësi, në shtypje dhe goditje.
- Të paktohet në mënyrë të tillë që të shmangen dëmtimet gjatë transsportit.
- Të plotesojë kërkesat sipas standarteve: **DS CEN/ TS 16209:2011 ose SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 ose ekuivalenteve te tij.**



Foto reference

12. Tavoline salle mbledhjesh/salle konferencash

- Tavolinë për sallë mbledhjesh të jetë me dimensione min (300 x 90/ h= 65) cm dhe maximum (310x 100/ h= 75) cm, me syprinë prej materiali MDF me trashësi/ spesor 2.5- 3.2 cm.
- Materiali duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm dhe lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë. Këndet e syprinës të jenë të rrumbullakosura. Në pjesët anësore dhe të dukshme, syprina të jetë e veshur me material plastic PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe më të njëjtën ngjyrë si struktura.
- Konstruksioni mbajtës në të cilin do të vendoset syprina, të jetë metalik, tubular në formë drjetëkëndore, me gjerësi të seksionit 4-8 cm. Në të gjithë gjatësinë e tavolinës të jenë të vendosur 3- 4 konstruksione të tilla të cilat të lidhen me njëra tjetrën nëpërmjet një ose dy elementeve të tjerë gjatësor me po të njëjtat dimensione, nëpërmjet saldimit.
- Lidhja të bëhet si në pjesën e sipërme ashtu edhe në pjesën e poshtme. Ky konstruksion të jetë prej çeliku, i qëndrueshëm ndaj goditjeve, shtypjeve dhe agjentëve të jashtëm, me dimensione (70- 80x h= 62-72) cm, në formë drejtëkëndore.
- Në pjesën e poshtme konstruksioni të pajiset me elemente prej gome ose plastike në mënyrë që të shmangen gërvishtjet në dysHEME.
- Të lyhet me bojë në ngjyrën e cila do të vendoset nga kontraktori.
- Montimi i syprinës të bëhet me anë të elementeve të forte dhe të qëndrueshëm në fortesi, në shtypje dhe goditje.
- Të paktohet në mënyrë të tillë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotesojë kërkesat sipas standarteve: **DS CEN/ TS 16209:2011 ose SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 ose ekuivalentëve të tij.**



Foto reference

13. Etazher për dosje me kanata dhe xham

- Etazher për dosje të jetë me dimensione min (90 x 45/ h= 200) cm dhe maximum (100x 55/ h= 210) cm. Struktura dhe sergjenët të jenë prej materiali MDF me trashësi/ spesor 1.8-3cm. Në

pjesët e dukshme të skeletit, sergjenëve dhe kanatave të jetë me veshje PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm.

- Këmbët e dollapit të jenë metalike, me lartësi 8-10cm dhe me mundësi nivelimi. Materiali të jetë çelik inoxi #304. Të jenë të pajisura me tapa plastike në pjesën e poshtme.
- Pjesa e poshtme të jetë 50-72cm dhe të ketë dy kanata prej të njëjtit material si struktura. Të jenë të pajisur me brave (për mobilje) në mënyrë që të mbyllen nga ana e jashtme me çelës. Hapësira e brendshme e kanatave të jetë e ndarë me një sergjen me lartësi të regjistrueshme prej materiali MDF me trashësi/spesor jo më të vogël se 18 mm.
- Hapësira në pjesën e sipërme të jetë me xham (i temperuar) i cili mund të jetë i inkorporuar ose jo në strukture metalike ose druri. Të jenë të pajisura me bravë (për mobilje) në mënyrë që të mbyllen në pjesën e jashtme me çelës. Në pjesën e brendshme kjo hapësirë të jetë përsëri e ndarë në 3 hapësira me anë të 2(dy) sergjenëve. Sergjenët të jenë me mundësi regjistrimi dhe të pajisur me tapa kundra gërvishtjes.
- Dorezat për kanatat të jenë prej material inoxi të cilësisë së parë dhe ergonomike.
- Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të plotësojë kërkesat sipas standartit: SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016+A1:2019 (EN, e njvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004 ose ekuivalentëve të tij.



Foto reference

14. Dollap inoxi për Reanimacion

- Dollap inoxi për reanimacion me dimesione min (250 x 50/ h =210) cm dhe maximum (260x 55/ h= 220) me katër kanata (dollap faqe muri). Secila kanatë të jetë me pesë ndarje (4 sergjene) me hapësirë jo më të vogël se 35 cm.
- Ndarjet (sergjenët) në pjesën me kanata të jenë me largësi njëra nga tjetra jo më të vogël se 30 cm.
- Materiali i dollapit do të jetë çelik inoxi Aisi 304. Materiali të jetë rezistent ndaj agjentëve të jashtëm, i qëndrueshëm dhe lehtësisht i pastrueshëm nga njollat dhe papastërtitë.
- Këmbët e dollapit të jenë prej material çelik inoxi # 304 me mundësi nivelimi. Të jetë i pajisur me tapa plastike në pjesën fundore kundër gërvishtjes.

- Kanatat të jenë të pajisura me brave (për mobilje) në mënyrë që të mbyllen nga ana e jashtme me çelës.
- Dorezat të jenë prej materiali metalik të cilësisë së lartë dhe ergonomike.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohen sipas kërkesave të nevojshme në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit të tyre.
- Të plotësojë kërkesat sipas standartit:
- :2012, EN 16122:2012/ AC:2015 ISO 13485:2016, ose ekuivalentëve të tij.



Foto reference

15. Rafte inoksi

- Raftet e inoksit të jenë me përmasa Min(70x45x190) cm dhe Max (80x50x200) cm.
 - Sistemi i rafteve përbëhet nga vetë struktura mbajtëse me 4 rafte të bëra nga fletë çeliku inoksi pa tehe të mprehta dhe armatura qendrore.
 - Kapaciteti i ngarkesës në raft: 160 kg.
 - Çelik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)
 - Të plotësojë kërkesat sipas standarteve: **ISO, CE, DS CEN/ TS 16209:2011 ose ekuivalentëve të tij.**



Foto reference

16. Kolltuk me hapje (bëhet shtrat tek)

- Kolltuku me permasa min (75x 75/ h=80) cm dhe maximum (85x 85/ h= 90) cm.
- Kolltuku është një mobilje që ndërthur cilësitë e një kolltuku të rehatshëm dhe një shtrati të rehatshëm, ndërsa në të njëjtën kohë siguron përshtatshmëri dhe komoditet.
- Për më tepër, ai kursen hapësirë dhe mund të përshtatet lehtësisht me situatën tuaj aktuale.
- Kolltuku i palosshëm është ideal për spitalet, duke u mundësuar njerëzve të shoqërojnë të dashurit e tyre dhe të jenë me të moshuarit ose të sëmurët edhe gjatë natës në shtratin e tyre.
- Kolltuku mund të hapet duke e tërhequr thjesht, duke mos u mbështetur në forcën e personit të ulur. Përbërësit e drurit të ahut përdoren në ndërtimin e pjesëve të dukshme, mbajtëse të shtratit.
- Kolltuku të jetë i veshur me tekstil ose lëkurë ekologjike, lehtësisht e pastrueshme nga njollat dhe papastërtitë, antibakteriale.
- Sfungjeri i ulësës të jetë cilësor me peshë 40 kg/m³.
- Pesha e përafërt 75 kg.
- Pesha maksimale e përdoruesit: 150 kg
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 16139:2013, EN 16139:2013/AC:2013.



Foto reference

17. Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)

- Poltroni dy vendësh të jetë me përmasa min (186 x 95 x 94) cm dhe maximum (200x100x100) cm.
- Të jetë me skelet druri.
- Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern.
- Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë.
- Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor.
- Këmbët të jenë prej materiali të kromuar.

- Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 16139:2013, EN 16139:2013/AC:2013



Foto reference

18. Poltron pritje njevendësh (kolltuk 1- vendësh)

- Poltroni njëvendësh të jetë me përmasa (92 x 89 x 84) cm dhe maximum (100x95x100) cm.
- Të jetë me skelet druri.
- Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern.
- Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë.
- Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor.
- Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 16139:2013, EN 16139:2013/AC:2013



Foto reference

19. Karrige ergonomike (me mbështetëse koke)

- Baza e karriges të jetë metalik në formën e yllit me 5 këmbëza në përmasat të përafërta (650-670) mm. Karriget të jenë rrotulluese dhe me rrota dyfishe, të përbëra me material termoplastik, i përforcuar (poliamide).
- Karrigia të jetë e pajisur me piston gazi për rregullimin e lartësisë. Mekanizmi mbështetës i ndenjësës duhet të jetë me mekanizëm "Synchro" dhe i bërë nga alumini dhe çeliku. Të lejojë shtrirjen e sinkronizuar të sediljes dhe mundësi stabilizimi në 4-5 pozicione.
- Ndenjësja duhet të ketë mekanizëm me sistem "anti-panik" dhe një sistem rregullimi për shtrirje të balancuar sipas peshës së përdoruesit. Ndenjësja të jetë prej poliamidi të derdhur me injeksion

(PA6). Mbushja me shkumë poliuretani i zgjeruar me trashësi jo më pak se 50 mm, i cili të jetë i veshur me susta dhe me stofin e zgjedhur.

- Dimensionet e ndenjës: gjerësia jo më pak se 480 mm, thellësia jo më pak se 480 mm. Pjesa e mbështetëses të ketë një kornizë anatomike të bërë nga poliamidi termoplastik, mbi të cilin rrjeta e pasme të vendoset në mënyrë të tillë që presioni të shpërndahet në mënyrë të barabartë.
- Pjesa e pasme duhet të ketë një mekanizëm të pavarur të rregullimit të lartësisë në jo më pak se 5 pozicione të ndryshme. Përveç kësaj, pjesa e pasme duhet të sigurojë një mbështetje të mesit, të integruar, me rregullim të lartësisë për rehati më të madhe.
- Mbështetësja të jetë në dimensionet të përafërta 570 x 475 mm. Karrigia duhet të ketë mbështetëse koke të rregullueshme në lartësi e bërë prej material termoplastik, shkumë poliuretani dhe tapiceri e të njëjtit material si ndenjësja.
- Krahët e karriges të jenë prej poliamidi termoplastik dhe të mund të rregullohen në lartësi, distanca nga sedilja 140-240 mm. Sipërfaqja e kontaktit të krahët të jetë e bërë nga poliuretani i derdhur me fortësi mesatare për rehati dhe ergonomi më të madhe, të lëvizshme majtas-djathtas, lartposhtë dhe para-mbrapa.
- Materiali i tapicerisë të jetë ekologjik sipas standarteve të certifikimit.
- Pesha e karriges 16-18 kg.
- Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018



Foto reference

20. Poltron rrotullues (Drejtuesi)

- Poltron rrotuelluese
- Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë.
- Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa.
- Duhet të ketë krahë anësore.
- Të ketë përshtatëse piston me gaz për nivelimin e lartësisë.
- Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur.

- Bazamenti duhet të jetë metalik ose plastik me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremet e tyre.
- Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018



foto reference

21. Poltron statik për tavolinë mbledhje

- Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë.
- Të ketë krahë anësore. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur.
- Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq i kromuar, i cili përshkon shpinën në dy anët e saj, ndenjësën dhe zbret në tokë duke u mbyllur në formë U-je, duke luajtur dhe rolin e bazamentit.
- Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 16139:2013, EN 16139:2013/AC:2013



Foto reference

22. Karrige plastike/ zyre

- Karrigia të jenë dizenuar me një stil modern, me katër këmbë të palëvizshme. Të jenë me dimensione min (45x 45/ h= 45) cm dhe maximum (55x 55/ h= 50) cm. Të projektuara me skelet metalik prej tubash me profil oval me diametër jo më të vogël se 1.3 cm.

- Të jetë e pajisur me tapa plastike në pjesën fundore të këmbëve në mënyrë që të shmangen gërvishtjet apo dëmtimet në dysheme.
- Karrigia të jetë me krah mbështetës me të njëjtin material si bazamenti.
- Shpinorja dhe ndenjësja të jenë prej material plastik polipropilen i cilësisë së lartë.
- Të jenë rezistente ndaj agjentëve të jashtëm dhe lehtësisht të pastrueshme nga njollat dhe papastërtitë.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohen sipas kërkesave në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat e standardeve: SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ose ekuivalentëve të tij.



Foto reference

23. Karrige plastike

- Karriget të jenë dizenuar me stil modern, me dimensione min (45x 45/ h= 45) cm dhe maximum (55x55/ h= 50) cm. Konstruksioni i tyre të jetë i ndërtuar nga këmbë metalike prej tubash me material çelik inoxi.
- Të jetë e lehtë në zhvendosje.
- Mbështetësja dhe ndenjësja të jenë material plastik prej polipropileni, lartësi jo me pak se 82cm nga dyshemeja deri në fundin e shpinores.
- Të jetë e projektuar në mënyrë të tillë që të ofrojë qëndrim ergonomik gjatë përdorimit.
- Materiali duhet të ofrojë qëndrueshmëri gjatë përdorimit dhe të pastrohet lehtë nga njollat dhe papastërtitë.
- Këmbët të jenë të pajisura me tapa plastike në pjesën fundore.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohen në mënyrë të tillë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat sipas Standarteve: SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ose ekuivalenteve të tij.



Foto reference

24. Dollap rrobash metalik për personelin 2 kanata

- Dollap për personelin me dimensione jo më të vogla se (65x 40/ h= 180) cm dhe maximum (70x 50/ h= 190) cm prej materiali çelik inoxi.
- Të jetë me 2 kanata të ndara njëra nga tjetra, e pajisur me (bravë) çelës për hapje dhe mbyllje nga jashtë. Dyert të jenë të pajisura me grilë për ajrosje.
- E gjithë struktura mbështet në 4 (katër) këmbë me material të njëjtë me strukturën. Këmbët në pjesën fundore të jenë të pajisura me tapa gome në mënyrë që të shmangen dëmtimet dhe gërvishtjet në dysheme.
- Pjesa e brendshme të jetë e ndarë në tre hapësira (dy sergjen) prej materiali të njëjtë me strukturën.
- Njera hapësirë të jetë e projektuar me shufër alumini për të varur rroba, ndërsa dy hapësirat e tjera të shërbejnë për të mbajtur objekte personale.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohet në mënyrë të tillë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat sipas standarteve: EN 16122:2012, EN 16122:2012/ AC:2015 ose ekuivalentëve të tij.



Foto reference

25. Dollap rrobash metalik per personelin 6 kanate

- Dollap për personelin për 6- poste me dimensione jo më të vogla se (99x 50/ h= 180) cm dhe maximum (110x 50/ h= 190) cm prej materiali çelik inoxi.
- Të jetë me 6 kanata të ndara njëra nga tjetra, e pjsur me (bravë) çelës për hapje dhe mbyllje nga jashtë. Dyert të jenë të pajisura me grilë për ajrosje.
- E gjithë struktura mbështet në 4 (katër) këmbë me material të njëjtë me strukturën. Këmbët në pjesën fundore të jenë të pajisura me tapa gome në mënyrë që të shmangen dëmtimet dhe gërvishtjet në dysHEME.
- Pjesa e brendshme të jetë e ndarë në dy hapësira (nje sergjen) prej materiali të njëjtë me strukturën.
- Njera hapësirë të jetë e projektuar me shufër alumini për të varur rroba, ndërsa hapësira tjetër të shërbejnë për të mbajtur objekte personale.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohet në mënyrë të tillë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat sipas standarteve: EN 16122:2012, EN 16122:2012/ AC:2015 ose ekuivalentëve të tij.



Foto reference

26. Recepsioni

- Reception në formë harku, me dimensione jo më të vogla se L1= 237cm (pjesa e brendshme) dhe L2 = 400 cm pjesa e jashtme me (R= 300 cm) dhe gjerësi totale 90 cm.
- Banaku do të jetë me dy nivele të lartësisë së syprinës.
- Syprina e parë të jetë me përmasa min (gjerësi 60cm dhe max 65) cm dhe h= 65- 75) cm, ndërsa tjetra jo min (gjerësi 25 cm dhe max 30 cm dhe h= 105 -120) cm. E gjithë syprina është në formë harku. Nga ana e djathtë syprina e sipërme ndërpritet në një distancë 50-65 cm nga muri.
- Banaku të jetë material Mdf me trashësi jo më të vogël se 2.6 cm.
- Të jetë me kënde të rrumbullakosura dhe të veshura me material plastik PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë me materialin e strukturës. Suprinat do të jenë me ngjyra të ndryshme njëra nga tjetra.
- Ngjyra e tij do të vendoset nga kontraktori.

- Në brendësi recepsioni do të ketë dy (2) komodina me dy sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45 x 80 /h= 65-70) cm me 4 rrota plastike të cilat të jenë rezistente në qëndrueshmëri, forcë dhe goditje.
- Të paktohen sipas kërkesave në mënyrë që të shmangen dëmtimet gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat sipas standarteve: **ISO, DS CEN/ TS 16209:2011 ose ekuivalentëve të tij**



Foto reference

27. Tavoline / Dhome relaxi

- Syprina e tavolinës të jetë prej materiali MDF, me spesor 1.6- 1.8 cm, i qëndrueshem në goditje, shtypje dhe të jetë lehtësisht i pastrueshem nga njollat, papastërtitë, antibakteriale dhe zjarrëduruese.
- DimENSIONI i syprinës të jetë jo më i vogël se (150 x 80/ h=65) cm dhe maximum (160x 90/ h=75) cm.
- Syprina e tavolinës të jetë e vendosur mbi strukturë metalike dhe me skaje të rrumbullakosura, jo të mprehta. Këmbët të jenë tubulare metalike (me seksion rrethor) ashtu si edhe struktura. Fundi i tyre të jetë me mundësi nivelimi dhe i veshur me tapa plastike kundër gërvishtjes.
- Ngjyra e strukturës metalike dhe e syprinës do të vendoset nga kontraktori.
- Të paktohen në mënyrë të tillë që të mos dëmtohen gjatë transportit.
- Të plotësojë kërkesat e standardeve: **ose ekuivalentit të tij.**
- Të plotësojë kërkesat e standardeve: SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004



Foto reference

28. Mobilje Kuzhine/ bufe

- Përmasat për pjesën e poshtme: (180 x 50 / h= 80) dhe maximum (200x 60/ h= 90) cm.
- Përmasat për pjesën e sipërme: (180 x 30 / h= 30) dhe maximum (200x 35/ h= 45) cm.
- Syprina: Bango me material Mdf për mobilje kuzhine me trashësi 4 cm dhe veshje kundër lagështirës. Struktura e kuzhinës të jetë me material Mdf me trashësi 18 mm – 26 mm.
- Kapaket dhe ballet e sirtareve sipas standarteve që i reziston avujve dhe nxehtësisë. Kuzhina është e montuar mbi këmbë të regjistruara dhe fiksuara për një qëndrueshmëri sa më të mirë.
- Pjesa e sipërme do të jetë prej material Mdf si edhe pjesa e poshtme, me trashësi 18mm -26 mm. Pjesët në dukje të jenë të veshura me material plastic PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë që do të ketë edhe struktura. Lidhja e hapësirave të brendshme të bëhet me material të një cilësie të lartë në mënyrë që të jenë rezistente ndaj agentëve të jashtëm dhe kohës.
- Dorezat të jenë rezistente ndaj avujve, agentëve të jashtëm, të jenë ergonomike.
- Modeli dhe ngjyra e tyre do të përcaktohet nga kontraktori.
- Të jetë e pajisur me lavapjatë me dy gropa, me piletë, me sifon dhe grupin e mishelatorit për lavapjatë (ujë i ngrohtë/ i ftohtë).
- Lavapjata të jetë material inoxi. Lavamani furnizohet i plotë me kullues, sifon, lidhje fleksibël me rrjetin e ujit dhe prizat për montim në mur. Çelik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27 mm).
- Të jetë cilësi e lartë me trashësi e cila parandalon shtypjet, gërvishtjet dhe zvogëlon zhurmën. Të jetë i qëndrueshëm, lehtësisht i pastrueshëm, kundra njollave, gërvishtjeve dhe të jetë antibakterial.
- Lavapjata të ketë të përfshirë aksesoret e fiksimit.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Për përcaktimin e saktë të dimensioneve duhet të bëhen matjet në vend.
- Perpara se të prodhohet duhet të behen matjet ne objekt ne menyre qe të përshtatet sa më mirë.
- Të plotësojë kërkesat e standardeve SSH EN 1116 : 2018: EN 16121:2023 ose ekuivalente për kuzhinen.
- Të plotësojë kërkesat e standardeve: SSH EN 13310:2015 +A1:2018 ose ekuivalente për lavapjatën.




Foto reference

29. Mobilje Kuzhine/ bufe (reanimacioni)

- Përmasat për pjesën e poshtme: (180 x 50 / h= 80) dhe maximum (200x 60/ h= 90) cm.
- Syprina: Bango me material Mdf për mobilje kuzhinë me trashësi 4 cm dhe veshje kundër lagështirës. Struktura e kuzhinës të jetë me material Mdf me trashësi 18 mm – 26 mm.
- Kapakët dhe ballet e sirtarëve sipas standarteve që i reziston avujve dhe nxehtësisë. Kuzhina është e montuar mbi këmbë të regjistruara dhe fiksuara për një qëndrueshmëri sa më të mirë.
- Pjesa e sipërme do të jetë prej material Mdf, me trashësi 18mm -26 mm. Pjesët në dukje të jenë të veshura me material plastik PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm dhe me të njëjtën ngjyrë që do të ketë edhe struktura. Lidhja e hapësirave të brendshme të bëhet me material të një cilësie të lartë në mënyrë që të jenë rezistente ndaj agentëve të jashtëm dhe kohës. Njëri prej hapësirave të parashikohet për vendosje lavastovilie.
- Dorezat të jenë rezistente ndaj avujve, agentëve të jashtëm, të jenë ergonomike.
- Modeli dhe ngjyra e tyre do të përcaktohet nga kontraktori.
- Te jete e pajisur me lavapjate me dy grapa, me piletë, me sifon dhe grupin e mishelatorit për lavapjatë (ujë i ngrohtë/ i ftohtë).
- Lavapjata të jetë material inoxi. Lavamani furnizohet i plotë me kullues, sifon, lidhje fleksibël me rrjetin e ujit dhe prizat për montim në mur. Çelik inox sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27 mm).
- Të jetë cilësi e lartë me trashësi e cila parandalon shtypjet, gërvishtjet dhe zvogëlon zhurmën. Të jetë i qëndrueshëm, lehtësisht i pastrueshëm, kundra njollave, gërvishtjeve dhe të jetë antibakterial.
- Lavapjata të ketë të përfshirë aksesorët e fiksimit.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Për përcaktimin e saktë të dimensioneve duhet të bëhen matjet në vend.
- Parpara se të prodhohet duhet të bëhen matjet në objekt në mënyrë që të përshtatet sa më mirë.
- Të plotësojë kërkesat e standardeve SSH EN 1116 : 2018: EN 16121:2023 ose ekuivalente për kuzhinën.
- Të plotësojë kërkesat e standardeve: SSH EN 13310:2015 +A1:2018 ose ekuivalente për lavapjatën.




Foto reference

30. Stol metalik 3- vendesh për pritje/ holl

- Të jetë i përbërë nga 3 karrige të lidhura bashkë ose të fiksuara në një strukturë metalike solide.
- Materiali të jetë kornize çeliku e kromuar.
- Të jetë lyer me ngjyrë metalike nëpërmjet procesit elektrostatik.
- Përmasat e stolit duhet të jenë jo më të vogla se (150x 40/ h= 45cm) dhe maximum (160x 50/ h=50) cm.
- Ndenjëset dhe shpinoret duhet të jenë me material llamarinë e brimëzuar dhe e lyer me ngjyrë metalike nëpërmjet procesit elektrostatik.
- Ato gjithashtu duhet të jenë rezistente ndaj deformimit, gërvishtjeve dhe të kenë formë të kurbëzuar sipas formave të trupit në vendet e mbështetjes. Në vendet e takimit me trupin mund të kenë edhe një shtresë amortizuese e cila mund të jetë me material rezistent dhe lehtësisht e pastrueshme.
- E pajisur me mbështetëse për krahët në të dy ekstremet.
